



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës  
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova  
Civil Aviation Authority of Kosovo

**Publikim Teknik – TP 27**

# **Procedurat për ndryshime në aerodrom**

**Doracak udhëzues**

Ky doracak është pronë e:

**Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës**

Lagjja Arbëria

Rruga Ahmet Krasniqi nr. 208

10000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Ndalohet çdo kopjim apo riprodhim i këtij materiali pa pëlqimin paraprak me shkrim të botuesit.

Shpërndarja paautorizuar e këtij doracaku, ose pjesëve të tij, jashtë procesit të rregulluar të shpërndarjes ose sistemit të trajtimit të brendshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës (AAC), do të cilësohet si shkelje serioze e procedurave të AAC-së dhe duke imponuar si e tillë do të ketë pasoja të përshtatshme për punonjësin përgjegjës për shpërndarjen e paautorizuar.

Personat e tillë tutje mund të ndiqen penalisht në institucionet e duhura të drejtësisë.

## Parathënie

Qëllimi i këtij doracakut është të sigurojë udhëzime për procedurat që do të përdoren për të njoftuar AAC-në për ndryshimet në një aerodrom, duke mbuluar edhe ndryshimet në infrastrukturë dhe ndryshimet në sistemin e menaxhimit, në mënyrë që këto zhvillime të mos komprometojnë kërkesat kombëtare dhe ndërkombëtare për operacionet e sigurta ajrore. Për më tepër, ai përfshin udhëzime për të siguruar që ndryshimet përputhen me kriteret e certifikimit dhe miratimit dhe menaxhohen në mënyrë të sigurt.

Operatorëve të aerodromit u kërkohet të informojnë dhe të kërkojnë pranimin paraprak nga AAC për çfarëdo ndryshimi. Njoftimi paraprak është për të siguruar që ndryshimet e infrastrukturës dhe sistemit të menaxhimit janë planifikuar siç duhet paraprakisht dhe është marrë pranimi paraprak i AAC-së. Kjo do të sigurojë që të respektohen kërkesat e rregulloreve kombëtare të Shtetit dhe të ICAO SARP.

Nëpër tërë dokumentin AAC-ja i referohet edhe aerodromeve të aprovuara edhe atyre të certifikuara. Për të sqaruar ndryshimin, duhet të theksohet se aerodromet “e aprovuara” janë ato të lëshuara me një aprovim të aerodromit në përputhje me Rregulloren për aerodromet e aprovuara, ndërsa aerodromet e certifikuara janë ato që lëshohen me një certifikatë aerodromi në përputhje me Rregulloren Nr. 17/2017 për dispozitat dhe procedurat administrative në lidhje me aerodromet.

Për më tepër, ky doracak ofron udhëzime për ata që janë përgjegjës për funksionimin e sigurt të një aerodromi ose objekteve teknike dhe për ata që janë përgjegjës për ndryshime, për të vlerësuar ndikimin që mund të ketë zhvillimi i propozuar në sigurinë e navigimit dhe operacioneve ajrore.

AAC kërkon që të gjitha palët e përfshira të jenë të njohura me përmbajtjen dhe procedurat e përshkruara këtu.

**Dritan Gjonbalaj**

Drejtori i Përgjithshëm

Autoriteti i Aviacionit Civil

## Lista e faqeve efektive

Kapitulli	Faqet	Nr. i Rishikimit	Data efektive
Parathënie	1 nga 30	Originali	18.06.2018
Lista e faqeve efektive	2 nga 30		
Tabela e aprovimit	3 nga 30		
Lista e shpërndarjes	4 nga 30		
Tabela e rishikimit			
Tabela e përmbajtjes	5 nga 30		
	6 nga 30		
Termet dhe përkufizimet	7 nga 30		
	8 nga 30		
KAPITULLI 0: E përgjithshme Hyrje	9 nga 30		
KAPITULLI 1: Dispozitat e Rregullores	10 nga 30		
1.1 Certifikimi i aerodromit			
1.2 Aprovimi i aerodromit	11 nga 30		
KAPITULLI 2: Angazhimi me AAC	12 nga 30		
2.1 Procesi i dorëzimit			
2.2 Takimet fillestare për ndryshime	13 nga 30		
KAPITULLI 3: Klasifikimi i ndryshimit të propozuar	14 nga 30		
	15 nga 30		
KAPITULLI 4: Planifikimi dhe përgatitja e projektit	16 nga 30		
KAPITULLI 5: Procesi i dorëzimit të kërkesave për ndryshim	17 nga 30		
5.1 Hyrje			
5.2 Ndryshimet të cilat kërkojnë aprovimin paraprak			
5.3 Procesi i aprovimit	18 nga 30		
	19 nga 30		
	20 nga 30		
	21 nga 30		
KAPITULLI 6: Ndryshimet në sistemin e menaxhimit (Vetëm aerodromet e certifikuara)	22 nga 30		
	23 nga 30		
KAPITULLI 7: Ndryshimet që nuk kërkojnë aprovim paraprak (Vetëm aerodromet e certifikuara)	24 nga 30		
	25 nga 30		
KAPITULLI 8: Projektet e mirëmbajtjes	26 nga 30		
KAPITULLI 9: Vlerësimi i rrezikut të sigurisë	27 nga 30		
SHTOJCA A: Metodologjia e vlerësimit të rrezikut të sigurisë	28 nga 30		
	29 nga 30		
SHTOJCA B: Procesi i ndryshimit - Grafiku i rrjedhës	30 nga 30		

**Tabela e aprovimit**

	<b>Emri dhe Pozita</b>	<b>Data</b>	<b>Nënshkrimi</b>
Përgatitur nga:	<b>Emir Hiseni,</b> Inspektor, Departamenti i Aerodromeve	02.05.2018	
Autorizuar nga:	<b>Burim Dinarama,</b> Drejtor, Departamenti i Aerodromeve	23.05.2018	
Kontrolli i cilësisë nga:	<b>Lendita Kika-Berisha,</b> Menaxhere e cilësisë dhe sigurisë	11.06.2018	
Aprovuar nga:	<b>Dritan Gjonbalaj,</b> Drejtor i Përgjithshëm	18.06.2018	

## Lista e shpërndarjes

Kopja nr.	Lokacioni	Media	Sasia
1	Biblioteka e AAC-së	Origjinal	1
2	Serveri i AAC-së	Digjital	1

## Tabela e Rishikimit

Nr. i Rish.	Data	Përgatitur nga:	Autorizuar nga:

## Tabela e përmbajtjes

Parathënie.....	1
Lista e faqeve efektive .....	2
Tabela e aprovimit .....	3
Lista e shpërndarjes .....	4
Tabela e Rishikimit .....	4
Tabela e përmbajtjes .....	5
Termet dhe përkufizimet .....	7
KAPITULLI 0: Të përgjithshme .....	9
Hyrje.....	9
Zhvillimi.....	9
Ndryshimet.....	9
Mirëmbajtja.....	9
Sistemi i menaxhimit.....	9
KAPITULLI 1: Dispozitat e Rregullores .....	10
1.1 Certifikimi i aerodromit .....	10
1.2 Aprovimi i aerodromit .....	10
KAPITULLI 2: Angazhimi me AAC.....	12
2.1 Procesi i dorëzimit.....	12
2.2 Takimet fillestare për ndryshime.....	13
KAPITULLI 3: Klasifikimi i ndryshimit të propozuar.....	14
KAPITULLI 4: Planifikimi dhe përgatitja e projektit.....	16
KAPITULLI 5: Procesi i dorëzimit të kërkesave për ndryshim.....	17
5.1 Hyrje.....	17
5.2 Ndryshimet të cilat kërkojnë aprovimin paraprak.....	17
5.2.1 Aerodromet e aprovuara .....	17
5.2.2 Aerodromet e certifikuara .....	17
5.3 Procesi i aprovimit .....	18
5.3.1 Pajtueshmëria: Aplikacioni për ndryshime (Pjesa 1).....	18
5.3.2 Kontrolli: Deklarata e kërkesave operative dhe sigurisë (Pjesa 2) .....	19
5.3.3 Përfundimi (Pjesa 3) .....	21
KAPITULLI 6: Ndryshimet në sistemin e menaxhimit (vetëm aerodromet e certifikuara).....	22

KAPITULLI 7: Ndryshimet që nuk kërkojnë aprovim paraprak (Vetëm aerodromet e certifikuara).....	24
KAPITULLI 8: Projektet e mirëmbajtjes.....	26
KAPITULLI 9: Vlerësimi i rrezikut të sigurisë .....	27
SHTOJCA A: Metodologjia e vlerësimit të rrezikut të sigurisë.....	28
1. Hyrje.....	28
2. Shtrirja e vlerësimit të sigurisë .....	28
3. Kriteret e sigurisë .....	28
SHTOJCA B: Procesi i ndryshimit – Grafiku i rrjedhës.....	30



## Termtat dhe përkufizimet

Termi	Përkufizimi
<b>Aerodrom</b>	Nënkupton një zonë të caktuar në tokë ose ujë (duke përfshirë gjithë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet), me qëllim që të përdoret tërësisht apo pjesërisht për ardhjen, nisjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve.
<b>Inspektor i aerodromit</b>	Inspektor i aerodromit nënkupton çdo person i autorizuar nga Autoriteti për të inspektuar një aerodrom.
<b>Aerodrome operator</b>	Është mbajtësi i certifikatës së aerodromit ose aprovimit të aerodromit;
<b>Aerodrom i aprovuar</b>	Nënkupton një aerodrom, operatorit të të cilit i është dhënë një aprovim aerodromi;
<b>Goditje nga zogjtë</b>	Nënkupton një përplasje midis një zogu në ajër dhe një avioni. Është një kërcënim i zakonshëm për sigurinë e avionëve dhe ka shkaktuar një numër aksidentesh fatale.
<b>CAA</b>	Nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës.
<b>Aerodrom i certifikuar</b>	Nënkupton një aerodrom, operatorit të të cilit i është dhënë një certifikatë aerodromi.
<b>Mjetet ndihmëse elektronike</b>	Nënkupton mjetet ndihmëse jo vizuale ose instrumentale që përdoren për navigimin ajror në aeroport.
<b>ICAO</b>	Nënkupton Organizatën Ndërkombëtare e Aviacionit Civil.
<b>Shtigjet e fluturimit me instrumente</b>	Ose fluturime IFR nënkupton një fluturim të kryer në përputhje me rregullat e fluturimit instrumental.
<b>Pengesë</b>	Nënkupton të gjitha objektet e fiksuara (përkohësisht ose në mënyrë të përhershme) dhe të lëvizshme, ose pjesë të tyre, të cilat janë të vendosura në një zonë të destinuar për lëvizjen sipërfaqësore të avionëve ose që shtrihen mbi një sipërfaqe të caktuar, të destinuar

	për të mbrojtur avionët gjatë fluturimit.
<b>Sipërfaqet e kufizimit të pengesave</b>	Nënkupton sipërfaqet e përcaktuara të hapësirës ajrore rreth aerodromeve që duhet të mirëmbahen nga pengesat.
<b>Pistë</b>	Nënkupton një zonë drejtkëndore e përcaktuar në një aerodrom tokësor e përgatitur për uljen dhe ngritjen e avionëve.
<b>Shenjë</b>	a) “Shenjë mesazhi e fiksuar”. Shenjë që paraqet vetëm një mesazh. b) “Shenjë mesazhi e ndryshueshme”. Shenjë që mund të paraqesë disa mesazhe të paracaktuara ose asnjë mesazh, sipas nevojës.
<b>Ndriçimi aeronautik në tokë (AGL)</b>	Nënkupton termin e përgjithshëm të përdorur për të përshkruar sistemet e ndryshme të ndriçimit që janë siguruar në një aerodrom për udhëheqjen e pilotëve që operojnë aeroplanët si gjatë natës ashtu edhe në kushte të dukshmërisë së ulët.
<b>Mjetet ndihmëse vizuale</b>	Nënkupton mjetet ndihmëse në aeroport që ndihmojnë vizualisht navigimin ajror në aeroport.
<b>Shtigjet e fluturimit vizual</b>	Ose fluturimet VFR nënkupton një fluturim të kryer në përputhje me rregullat e fluturimit vizual.

## KAPITULLI 0: Të përgjithshme

### Hyrje

Objektivi kryesor i AAC është të përmirësojë sigurinë në partneritet me industrinë dhe të sigurojë që frekuenca e incidenteve të mos rritet në përputhje me rritjen e parashikuar të trafikut. Zhvillimi i aerodromit duhet të përfshijë përmirësimin e standardeve ekzistuese të sigurisë kur është e mundur, ose ruajtjen e tyre aty ku nuk mund të arrihet një përmirësim i tillë. Ky publikim ka për qëllim të ndihmojë operatorin e aerodromit në planifikimin efektiv dhe menaxhimin e sigurt të zhvillimit në aerodrom.

Për qëllimet e këtij dokumenti, ekzistojnë 4 kategori të përcaktuara si më poshtë:

#### **Zhvillimi (Ndërtimet në aerodrom)**

Aty ku do të ndërtohet një infrastrukturë e re ose të rindërtohet ajo ekzistuese. Shembujt përfshijnë ndërtesat e reja ose shtesat në ndërtesa, infrastrukturën e aerodromit (siç janë rrugët lidhëse në platformë dhe platforma), mjetet ndihmëse vizuale dhe mjetet ndihmëse të navigimit. Zhvillimet klasifikohen si të mëdha ose të vogla, detajet e të cilave janë dhënë në Kapitullin 3.

#### **Ndryshimet**

Aty ku infrastruktura ekzistuese e aerodromit ose karakteristikat fizike janë duke u ndryshuar, për shembull rikonfigurimi i vendndalesave të avionëve, ndryshimet në pistë ose distancat e deklaruara. Ndryshimet përfshijnë projekte që përfshijnë heqjen ose ndryshimin e mospërputhjeve ekzistuese të aerodromit.

#### **Mirëmbajtja**

Aty ku infrastruktura ekzistuese është duke u riparuar, rinovuar ose zëvendësuar, por pa ndryshuar karakteristikat e pjesës së infrastrukturës. Shihni Kapitullin 8.

#### **Sistemi i menaxhimit**

Ndryshime të rëndësishme në sistemin e menaxhimit, që përfshijnë ndryshime në strukturën organizative. Nuk synohet që ndryshimet në personel të kenë nevojë për miratim paraprak nga AAC, megjithatë kur synohet që një pozitë individuale të marrë përgjegjësi shtesë ose ndryshon linja e raportimit e strukturës aktuale, ka të ngjarë që kjo do të ketë nevojë për miratim paraprak. Kjo kërkesë vlen vetëm për aerodromet e certifikuara.

## KAPITULLI 1: Dispozitat e Rregullores

### 1.1 Certifikimi i aerodromit

Certifikimi i një aerodromi duhet të bëhet në përputhje me Rregulloren Nr. 17/2017 për Dispozitat dhe Procedurat Administrative që lidhen me Aerodromet, 'Rregullorja për Aerodromet e Certifikuara'. Kur një aerodrom merr certifikatën e tij, ajo lëshohet në bazë të përmbushjes së kriterëve për certifikim të aerodromit, duke përfshirë krijimin e një Baze Certifikimi (CB) dhe një sistemi të menaxhimit.

Rregullorja për aerodromet e certifikuara kërkon që çdo ndryshim në objektet e aerodromit dhe në ato procedura dhe politika që kanë potencialin për të:

1. ndikuar në kushtet e certifikatës, bazën e saj të certifikimit dhe në pajisjet që janë kritike për sigurinë e aerodromit; ose
2. ndikuar ndjeshëm në elementet e sistemit të menaxhimit të operatorit të aerodromit

duhet të merr miratimin paraprak nga AAC (ADR.OR.B.040 (a) Ndryshimet).

Për ndryshimet e tjera që kërkojnë miratim paraprak në përputhje me Rregulloren Nr. 03/2009, të ndryshuar, ("Rregullorja Themelore") dhe rregullave zbatuese të saj, operatori i aerodromit duhet të kërkojë dhe ta marr miratimin e lëshuar nga AAC (ADR.OR. B.040 (b) Ndryshimet).

Ky publikim përcakton këto dhe ndryshimet tjera të cilat nuk kërkojnë miratim paraprak (shih Kapitullin 7).

### 1.2 Aprovimi i aerodromit

Dhënia e një aprovimi të aerodromit rregullohet nëpërmjet Rregullores për aprovimin e aerodromit. AAC ia lëshon një aprovim operatorit të aerodromit në bazë të përmbushjes së kriterëve të aprovimit të aerodromit, përveç nëse këto ndryshime në kriteret nuk janë dakorduar ndryshe nga AAC. Sidoqoftë, aerodromi duhet të jetë i sigurt për përdorim nga avionët, duke marrë parasysh sidomos karakteristikat fizike të aerodromit dhe rrethinës së tij.

Një kusht për aprovimin e aerodromit kërkon që ndryshimet në karakteristikat fizike të aerodromit, duke përfshirë ndërtimin e objekteve të reja dhe ndryshimet në objektet ekzistuese ose ndihmat vizuale, nuk bëhen pa miratimin paraprak nga AAC-ja. Qëllimi i kësaj është që të sigurohet që AAC të jetë e kënaqur që ndryshimet në karakteristikat fizike të plotësojnë kriteret e aprovimit dhe se nuk paraqesin rrezik për sigurinë.

Propozimet e projektit duhet të jenë në përputhje me kriteret e përfshira në rregulloret përkatëse. Për më tepër, disa propozime ofrojnë një mundësi për të shqyrtuar mospërputhshmëritë ekzistuese, me qëllim të largimit, kur kjo është e mundur. Kur një mospërputhshmëri nuk mund të largohet, duhet të bëhet një vlerësim mbështetës i rrezikut, duke marrë parasysh operacionet aktuale dhe të parashikueshme, dhe rezultati i analizës të veprave në përputhje me rrethanat.

## KAPITULLI 2: Angazhimi me AAC

### 2.1 Procesi i dorëzimit

Qëllimi i njoftimit paraprak është që të sigurohet se ndryshimet në objektet, pajisjet dhe nivelin e shërbimit të aerodromit janë planifikuar në përputhje me Rregulloret Kombëtare dhe SPR-të e ONAC.

Një Aerodrom është organizatë komplekse me shumë disiplina dhe funksione interaktive. Prandaj, është e mundur që edhe zhvillimet më të thjeshta mund të kenë nevojë për bashkërendim ndërmjet departamenteve. Për të iniciuar procedurën e zhvillimit, operatori i aerodromit duhet të emërojë një koordinator të projektit që të vendosë ndërlidhje me AAC.

Varësisht prej kompleksitetit të ndryshimit të propozuar, operatori i aerodromit duhet të informoj AAC-në në mënyrë elektronike përmes postës elektronike ose përmes kopjes fizike lidhur me ndryshimet, përpara datës së parashikuar të zbatimit, për të dhënë kohë të mjaftueshme për proceset e vlerësimit dhe aprovimit. Tabela e mëposhtme mund të ndihmojë si shembull në procesin e planifikimit, megjithatë rekomandohet angazhimi me AAC-në në mundësinë e parë të dhënë:

Zhvillimet që ndikojnë në	Koha minimale e lejuar
Ndihmat e afrimit dhe hapësira ajrore	6 muaj para përfundimit të projektit
Instalimi i pajisjeve të reja të ATC	6 muaj para instalimit
Instalimi i ndriçimit të ri tokësor	6 muaj para instalimit

AAC do të vlerësojë ndryshimin e propozuar dhe do të vendos nëse projekti është i vogël ose i madh, duke përdorur kriteret e paraqitura në Kapitullin 3, dhe do të informojë operatorin e aerodromit në përputhje me rrethanat për të vazhduar me aplikimin zyrtar, nëse kjo është e zbatueshme.

Për aerodromet e certifikuara, ndryshimet të cilat kërkojnë aprovim paraprak nga AAC (shih paragrafin 5.5) duhet të dorëzohen duke përdorur formularin AACK/AGA-FRM 23.

Për aerodromet e aprovuara, ndryshimet të cilat kërkojnë aprovim paraprak nga AAC duhet të dorëzohen duke përdorur formularin AACK/AGA-FRM 24.

Operatori i Aerodromit duhet të jetë i vetëdijshëm se projektet e rëndësishme të mirëmbajtjes mund të rezultojnë në një efekt dytësor në Bazat e Certifikimit, p.sh. instalimi i ndriçimit tokësor të ri të aerodromit si pjesë e projektit të rehabilitimit të pistës/rrugës lidhëse në platformë dhe, për këtë arsye, mund të kërkojë aprovimin paraprak. Për projektet e mirëmbajtjes, shih Kapitullin 8.

Në rastin e aerodromeve të certifikuar, kur ndryshimi i propozuar ndikon ndjeshëm në Bazën e Certifikimit, operatori duhet të aplikojë për ndryshimin e certifikatës duke përdorur formularin AACK/AGA-FRM 01.

## 2.2 Takimet fillestare për ndryshime

Për të informuar AAC-në lidhur me ndonjë ndryshim të madh dhe kur AAC e konsideron si të dobishme, duhet të organizohet Takimi Fillestar për Ndryshime (TFN). Në këtë TFN, kur është e mundur, duhet të përfshihen të gjitha aspektet e ndryshimit. Një prezantim nga operatori i aerodromit shpesh dëshmohet si mënyra më e suksesshme për informimin e të gjithë pjesëmarrësve. Operatori i aerodromit duhet të mbajë shënimet e takimit dhe ato duhet të pranohen nga të gjitha palët.

Do të ishte ideale që planet dhe skicat e hartuara të vihen në dispozicion të AAC-së para TFN-së, në kohë të mjaftueshme, për të siguruar që takimi të arrijë dobinë maksimale. Mund të priten edhe takime të mëtejshme, qoftë gjatë periudhës së përgatitjes për të bërë ndryshimet apo edhe gjatë ndryshimit.

Është e rëndësishme që të gjitha fushat e ndikuara nga ndryshimi të përfshihen në TFN dhe që të gjitha departamentet e nevojshme brenda AAC-së dhe përfaqësuesit e autoriteteve përgjegjëse të ftohen që të marrin pjesë.

AAC do të merret drejtpërdrejt me operatorin e aerodromit ose përfaqësuesin e tij të emëruar.

## KAPITULLI 3: Klasifikimi i ndryshimit të propozuar

Zhvillimet e aerodromit klasifikohen ose si të mëdha ose të vogla. AAC do të vlerësojë në detaje secilin propozim të zhvillimit dhe do ta klasifikojë atë si zhvillim të madh ose të vogël varësisht prej nivelit të mbikëqyrjes rregullatore të paraparë për përfundim të kënaqshëm të projektit. Ekipi do të sigurojë që të gjitha propozimet e zhvillimit vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, do të shpjegojë arsyet e vendimit të arritur, dhe gjithashtu mund të përfshijë operatorin e aerodromit për të ndihmuar në procesin e vlerësimit. AAC do të informojë me shkrim aerodromin për rezultatin e procesit të vlerësimit dhe arsyetimin për vendimin.

Kriteret e përdorura për të vendosur nëse një zhvillim konsiderohet si i madh apo i vogël mund të përfshijnë si vijon, megjithëse kjo listë nuk është shteruese:

- Komplexiteti i zhvillimit/ndërtimit;
- Numri i kërkuar i vizitave në vendngjarje;
- Ndikimi në operacionet e aerodromit (niveli i pengesave për operimet normale);
- Ndryshimet që duhet të bëhen në operimet e aerodromit që shkaktohen nga objekti i ri;
- Ndryshimet që duhet të bëhen në Manualin e aerodromit;
- Nëse zhvillimi do të krijonte një mospërputhshmëri të re që do të kërkonte vlerësim të hollësishëm;
- Niveli i kërkuar ndërlidhjes së brendshme të AAC-së - Shërbimet e Trafikut Ajror, Operacionet e Fluturimit, Hapësira ajrore/Procedurat e Fluturimit me anë të Instrumenteve).

Zakonisht, projektet e listuara në Tabelën 1 janë ato që mund të kualifikohen si zhvillim i madh dhe për të cilat AAC mund të vendos tarifa për sa i përket aprovimit të zhvillimit dhe ndryshimit të certifikatës së aerodromit. Kjo listë është vetëm indikative dhe projektet mund të përjashtohen ose përfshihen, varësisht prej kompleksitetit të propozimit dhe mbikëqyrjes së kërkuar rregullatore.

**Tabela 1: Zhvillimet të cilat mund të klasifikohen si 'të mëdha'**

Projekti	Përshkrimi
Pista e re	Një zhvillim që rezulton në ndërtimin e një pistë 'të re' (p.sh. ndërtim i ri ose ndryshimi i barit ekzistues në sipërfaqe të fortë).
Zgjatja e pistës	Një zgjatje e pistës që rezulton në një ndryshim në distancat e deklaruara ose sigurimi i një RESA shtesë.
Zhvendosja e pragut (statusi i instrumentit)	Një zhvillim që përfshin zhvendosjen e pragut të instrumentit të pistës, ose zhvendosjen e një pragu jo-instrumental të pistës në përgatitje të statusit të instrumentit.
Instalimi i ndriçimit tokësor te aeroportit - AGL, statusi i instrumenteve të pistave	Një instalim ose përmirësim i ndriçimit, i destinuar për të lehtësuar operacionet shtesë (p.sh. për të akomoduar operacionet me shikueshmëri të ulët dhe/ose operimet gjatë natës).



Objektet/strukturat e reja	Një propozim që përfshin një terminal të ri ose zgjerim të terminalit, hangarëve ose të ndonjë strukture tjetër që mund të ndikojë në operacionet e avionëve.
Instalimi i mjeteve ndihmëse të navigimit	Një instalim i ILS ose MLS, shtegut të rrëshqitjes ose pajisjeve të ndërlidhura, radarit, ose pajisjeve të tjera të navigimit.
Zhvillimi i rrugës lidhëse "taxiway"	Një rrugë e re lidhëse ose një ndryshim i konsiderueshëm në sistemin ekzistues të rrugës lidhëse.
Zhvillimi i platformës	Një platformë e re ose zhvillim i platformës me një rritje të konsiderueshme të sipërfaqes.
Kulla e re apo e zëvendësuar e kontrollit vizual (KKV)	Përfshirja e një KKV të re ose zëvendësimi i saj.
Çdo zhvillim tjetër që ndikon materialisht mbi bazën sipas të cilës është lëshuar certifikata ose aprovimi i aerodromit.	

## KAPITULLI 4: Planifikimi dhe përgatitja e projektit

Ndryshimet shpesh kërkojnë planifikim të gjerë, prandaj duhet të merren në konsideratë fushat e dhëna më poshtë. Megjithatë, theksohet se kjo listë as nuk është e detyrueshme dhe as shteruese, dhe dihet që këto elemente mund të mos jenë të disponueshme ose të zhvilluara plotësisht në fazën e planifikimit:

- Ndriçimi aeronautik në tokë
- Ndryshimet në Manualin e aerodromit
- Procedura e trafikut ajror gjatë dhe pas zhvillimit
- Kërkesat e linjës së vëzhgimit të ATC
- Implikimet e rrezikut nga bota shtazore
- Turbulenca e shkaktuar nga ndërtesa
- Ndryshimet në procedurat ekzistuese të operimit të aerodromit
- Ndryshimet në densitetin e fushës magnetike si rezultat i zhvillimit
- Procedurat në raste emergjente
- Ndikimi mjedisor
- Procedurat e afrimit dhe largimit me anë të instrumenteve dhe minimumi i tyre
- Procedurat e menaxhimit të sigurisë së projektit (përvijim)
- Afati kohor i propozuar
- Procedurat e rishikuara të dukshmërisë së ultë
- Tërheqja e certifikatës/variantet e aprovimit
- Masat e rishikuara të parandalimit të inkursionit në pistë
- Sinjalistika
- Plani i qasjes në vendndodhje
- Masat e sigurimit, siç kërkohet nga programi i sigurimit të aerodromit

Sa herë që propozohet një projekt, është thelbësore të përcaktohet nëse ai do të rezultojë në një ndryshim në procedurat e përcaktuara të funksionimit në aerodrom. Prandaj, në një fazë të hershme, operatorët e aerodromit duhet të kryejnë identifikimin e rrezikut dhe vlerësimin e rrezikut për të identifikuar rreziqet e mundshme dhe rreziqet e lidhura me secilin ndryshim të propozuar, duke përfshirë ndikimin tek palët e interesuara.

Niveli i detajeve duhet të jetë siç kërkohet nga rregullorja përkatëse dhe gjithashtu duhet të jetë në përpjesëtim me madhësinë dhe kompleksitetin e ndryshimit.

## KAPITULLI 5: Procesi i dorëzimit të kërkesave për ndryshim

### 5.1 Hyrje

AAC-ja ka zhvilluar një proces 3-fazësh për të ndihmuar aerodromet dhe për të siguruar që operatorët e aerodromit i përmbushin detyrimet e tyre sipas rregullores së tyre përkatëse. Ky kapitull jep në hollësi informacionet e kërkuara për secilën prej 3 fazave dhe procesin që duhet të ndiqet.

Ky proces duhet të përdoret për të gjitha ndryshimet që kërkojnë aprovimin paraprak. Është e pranueshme të dorëzohen së bashku Pjesët 1 dhe 2.

Procesi i dorëzimit të kërkesave përbëhet prej 3 pjesëve të veçanta:

- Pjesa 1: Pajtueshmëria
- Pjesa 2: Kontrolli
- Pjesa 3: Realizimi

### 5.2 Ndryshimet të cilat kërkojnë aprovimin paraprak

#### 5.2.1 Aerodromet e aprovuara

Për aerodromet e aprovuara, të gjitha ndryshimet në infrastrukturë kërkojnë aprovim paraprak nga AAC, siç përcaktohet në kushtet e aprovimit të aerodromit.

Për më tepër, AAC mund, me kusht që të përmbushen kërkesat e Rregullores për aerodromet e aprovuara, të ndryshojnë një aprovim të aerodromit, në rastet kur:

- është bërë ndryshimi i operatorit të aerodromit;
- është bërë ndryshimi i përdorimit ose operimit të aerodromit;
- është bërë ndryshimi i kufijve të aerodromit;
- personi që posedon aprovimin e aerodromit kërkon ndryshimin.

#### 5.2.2 Aerodromet e certifikuara

Për aerodromet e certifikuara, përveç ndryshimeve të kërkuara në ADR.OR.B.040 (a)(1), që ndikojnë në kushtet e certifikatës, bazën e saj të certifikimit dhe pajisjet e aerodromit që janë kritike për sigurinë, AAC kërkon që edhe ndryshimet vijuese të nënshtrohen aprovimit paraprak:

- Ndryshimet që ndikojnë ndjeshëm në elementët e sistemit të menaxhimit të operatorit të aerodromit siç kërkohet nga ADR.OR.B.040 (a) (2) Ndryshimet;
- Ndryshimet që ndikojnë në DAAD;
- Përdorimi i mjeteve alternative të përputhshmërisë siç kërkohet nga ADR.OR.A.015 Mjetet për përputhshmëri;

- Ndryshimet në procedurën e administrimit dhe njoftimit për ndryshimet që nuk kërkojnë aprovimin paraprak, siç kërkohet nga ADR.OR.B.015 (b)(4) Aplikimi për një certifikatë;
- Ndryshimet në nivelin e mbrojtjes së shërbimeve për shpëtim dhe zjarrfikje, siç kërkohet nga ADR.OPS.B.010 (a)(1)(2) Shërbimet për shpëtim dhe zjarrfikje;
- Ndryshimet në procedurat e operimit në dukshmëri të ulët, siç kërkohet nga ADR.OPS.B.045(b) Operimet në dukshmëri të ulët (LVO);
- Operimi i avionëve në aerodrome me kod më të lartë, siç kërkohet nga ADR.OPS.B.090 (a) Përdorimi i aerodromit nga avionë me kod më të lartë;
- Ndërtimet që ndikojnë në linjën e vrojtimit të ATC;
- Vendosja e treguesve të ri të erës apo zhvendosja e tyre;
- Zhvillimet në zonën e lëvizjes (p.sh. platformat e reja, rrugët lidhëse);
- Zhvillimet që mund të ndikojnë në zonën e lëvizjes (p.sh. ndërtimi i terminaleve të reja apo zgjerimi i tyre); ose
- Projektet e konsiderueshme të mirëmbajtjes (p.sh. rehabilitimi i pistës).

Për më tepër, operatori duhet të aplikojë për aprovim të ndryshimeve për çdo pengesë, zhvillim dhe aktivitete të tjera brenda zonave të monitoruara nga operatori i aerodromit në përputhje me ADR.OPS.B.075, të cilat mund të rrezikojnë sigurinë dhe të ndikojnë negativisht në operacionet e një aerodromi, siç kërkohet nga ADR.AR.C.005 (e).

## 5.3 Procesi i aprovimit

### 5.3.1 Pajtueshmëria: Aplikacioni për ndryshime (Pjesa 1)

Çdo propozim për ndryshim duhet të dorëzohet duke përdorur formularin e duhur (AACK/AGA-FRM 23 ose AACK/AGA-FRM 24), duke ofruar dëshmi të qarta që ndryshimi përputhet me rregulloren përkatëse, duke përfshirë:

- Rishikimi i ndryshimeve;
- Dokumentacioni mbështetës, kur është e aplikueshme (p.sh. Dokumentacioni i garantimit të sigurisë ose vlerësimi i ndryshimit);
- Matrica e pajtueshmërisë (për të demonstruar që modeli i projektit i plotëson kërkesat rregullatore); dhe
- Skicat e shkallëzuara, kur është e aplikueshme.

Kur AAC të ketë vlerësuar parashtresën e Pjesës 1 dhe të jetë e kënaqur që ndryshimi i plotëson kërkesat rregullatore, atëherë AAC do të aprovjë ndryshimin. Duhet të theksohet se kur lëshohet një aprovim i Pjesës 1 dhe propozohet një ndryshim i mëpasshëm për projektim ose ndërtim, informacionet e modifikuara duhet t'i komunikohen AAC-së.

### 5.3.2 Kontrolli: Deklarata e kërkesave operative dhe sigurisë (Pjesa 2)

Pas përfundimit dhe pranimit të projektit të zhvillimit, operatori i aerodromit duhet t'i demonstroj AAC-së që projekti do të menaxhohet në mënyrë të sigurt. Në përputhje me rrethanat, AAC pret nga operatorët e aerodromit të përgatisin dokumentacionin e garantimit të sigurisë që përshkruan se si do të menaxhojë aerodromi punimet e ndërtimit, dhe procedurat operative, për të siguruar që operacionet e aerodromit të mund të vazhdojnë në mënyrë të sigurt gjatë realizimit të projektit. Operatorët e aerodromit duhet të zhvillojnë dhe zbatojnë një sistem formal për kontrollin e rreptë, menaxhimin e sigurisë, ruajtjen dhe koordinimin e sigurisë së të gjitha punëve ajrore. Dokumentacioni i garantimit të sigurisë mund të ketë shumë forma, por ai duhet të jetë në përpjesëtim me madhësinë e projektit.

Operatori i aerodromit duhet të siguroj që sistemet për kontroll dhe menaxhim të sigurt të shtrihen tek kontraktuesit që punojnë në aerodrom.

Të gjithë anëtarët e ekipit të menaxhimit të projektit duhet të kenë përgjegjësi dhe llogaridhënie të përcaktuara qartë në programin e projektit. Gjatë ndërtimeve në një aerodrom, nivelet e sigurisë dhe standardet e sjelljes duhet të respektohen. Këto janë thelbësore për promovimin e sigurisë, për parandalimin e aksidenteve dhe përmbushjen e kërkesave të certifikimit të aerodromit.

Është e rëndësishme që informacionet e sakta, të azhurnuara, të jenë të disponueshme për të gjitha palët e interesit të përfshira në projekt, duke përfshirë AAC-në, si pjesë e planifikimit të projektit, si dhe gjatë vetë kryerjes së punës. Prandaj, dokumentacioni i garantimit të sigurisë dhe menaxhimit të projektit mund të përfshijnë ndonjë ose të gjitha informacionet e mëposhtme:

- Një deklaratë e qartë e strukturës së mbikëqyrjes për menaxhimin e sigurisë dhe monitorimin e punimeve, përfshirë detajet e kontaktit të personelit kryesor në fjalë, si për menaxhimin e projektit ashtu edhe për aerodromin. Kjo deklaratë duhet të përfshijë përgjegjësi të qarta, duke përfshirë personin me përgjegjësi të përgjithshme për zhvillimin;
- Procedurat e operimit në fushën ajrore gjatë zhvillimit, duke përfshirë rastet e paparashikuara siç janë procedurat për operim në dukshmëri të ulët;
- Aranzhimet për takime/konferencë ndërlidhëse midis menaxherëve të aerodromit dhe kontraktuesve;
- Planet dhe diagramet e përshtatshme lidhur me procesin e kontraktimit;
- Kontrollimi i kontraktuesve;
- Fillimi i ditës dhe natës, kontrolli dhe përfundimi i procedurave të punës;
- Procedurat e komunikimit midis njësive operative të aerodromit (p.sh. ATC, Operatori në fushë ajrore) dhe ekipet e ndërtimit;
- Procedurat e emergjencës;
- Metoda e punës;
- Planet e lokacionit dhe diagramet e punimeve;
- Plani i qasjes në lokacion;
- Mbrojtja dhe shënjimi i lokacionit;

- Kushtet minimale të motit që do të ndikojnë në punime;
- Plani i përgjithshëm i aerodromit, përfshirë pikat e hyrjes në zonën ajrore;
- Lokacioni dhe kufijtë e zonave të punimeve;
- Pikat specifike të sigurisë së qasjes që do të përdoren, si dhe lokacioni dhe shënjimi i rrugëve të qasjes që do të përdoren për të arritur në vendet ajrore;
- Metodatat e kontrollit dhe qasjes në lokacionet e punimeve brenda Zonës së Platformës dhe Manovrimit, duke përfshirë aranzhimet për kalimin e rrugëve lidhëse dhe pistat (nëse është e aplikueshme);
- Metodatat dhe pajisjet që do të përdoren për mbrojtjen, shënjimin dhe ndriçimin e kufijve të vend punishteve dhe për mbrojtjen e operimeve normale të aerodromit në afërsi të lokacionit. Gjithashtu, kërkesa për të kontrolluar ndriçimin e lokacionit për të parandaluar shpërqendrimin e ekuipazheve të avionëve, shoferëve dhe ATC;
- Koha rreptësisht e përcaktuar për rregullimin e vend punishteve, fillimi i orarit të punës, orët e lejuara ditore të punës në lokacion dhe procedurat që duhet të përfillen për fillimin dhe ndërprerjen e punës;
- Nuk duhet të rrezikohen procedurat e emergjencës së aerodromit, duke përfshirë kohën e reagimit gjatë periudhave të punës që është në vazhdim e sipër. Kjo shtrihet për t'u siguruar se janë vendosur rregullime kompenzuese për të mbuluar shterjen e furnizuesve kryesor të hidrantëve ose hidrantët kundër zjarrit kur çaktivizohet furnizuesi kryesor i hidrantëve kundër zjarrit për shkak të punëve që janë në vazhdim e sipër;
- Kërkesat për automjete dhe pajisje, rregullat e operimit dhe kërkesat për disiplinën e personelit;
- Llogaritja dhe komunikimi i ndryshimeve të distancave të deklaruara;
- Ruajtja e karakteristikave të duhura të fërkimit të shtresës së pistës;
- Informacionet mbi kërkesat e veçanta të sigurisë për operacionet e avionëve në afërsi të vendeve ku kryhen punimet dhe metodatat e disponueshme të kontrollit në Zonën e Manovrimit, duke përfshirë procedurat e radio telekomunikacionit, nëse kjo është e përshtatshme;
- Aranzhimet për kontrollimin special të kryerjes së 'punëve të nxehta';
- Kërkesat për operimin e vinçave dhe strukturave të tjera të larta;
- Aranzhimet për pranimin dhe lëvizjen e ngarkesave të rënda ose të mëdha;
- Kërkesat për mbajtjen e pastërtisë së automjeteve dhe të zonës, gjithashtu implikimet e Mbeturinave të Objekteve/Copëzave të Lira (FOD) si dhe rreziqeve nga materialet e lirshme për operacionet e avionëve;
- Aranzhimet për largimin e mbeturinave;
- Informacionet lidhur me implikimet e sigurisë për lokacionin dhe stafin nga rreziqet e veçanta të avionëve, duke përfshirë shpërthimin e ajrit, dridhjen, avujt/gazrat dhe zhurmën;
- Informacionet lidhur me efektet e erërave të forta në aerodrom;
- Siguria e lokacionit, duke përfshirë mbrojtja e personelit.

Rregullat dhe udhëzimet për kontrollin e punës janë dhënë në Mënyrat e Pranueshme të Përputhshmërisë (AMC) dhe Materialin Udhëzues (GM) në ADR.OPS.B.070.

Operatori i aerodromit duhet të sigurohet që të gjitha palët e interesuara të njoftohen me kohë për projektet që do të realizohen në aerodrom. Këto komunikime duhet të vazhdojnë gjatë realizimit të projektit dhe mund të përfshijnë Udhëzimet e Sigurisë, Qarkoret e Informacioneve të Aerodromit, Njoftimet për Personelin e Aviacionit (NOTAM) ose procedurat e tjera vendore.

Para se kontraktuesit të fillojnë punimet në çfarëdo lokacioni të aerodromit, operatori i aerodromit duhet të siguroj një informim gjithëpërfshirës rreth sigurisë ('*safety briefing*'), duke përfshirë rezultatet e analizave të vazhdueshme të rrezikut, për tu siguruar se janë kuptuar dhe dakorduar qartë të gjitha informacionet e nevojshme për të arritur përfundimin e sigurt të çdo punimi ose veprimtarie. Për më tepër, operatori i aerodromit duhet të mbajë takime të rregullta të progresit të punëve, për tu siguruar që siguria e projektit dhe objektivat operacionale vazhdojnë të jenë të përmbushura. Duhet të bëhet një monitorim i afërtë i sigurisë së operacioneve të aerodromit, gjersa punimet e projektit të jenë në proces e sipër dhe, kur merren vendime, përparësitë e projektit duhet të jenë në përpjesëtim me respektimin e standardeve të sigurisë.

Kur AAC të jetë siguruar se aerodromi mund të vazhdojë të operojë në mënyrë të sigurt gjatë realizimit të projektit, do të jepet aprovimi për fillimin e punimeve.

### 5.3.3 Përfundimi (Pjesa 3)

Kthimi në shërbim është një fazë kritike e projektit dhe mund të paraqesë sfida komplekse. Duhet të përcaktohet një planifikim i kujdesshëm dhe procedura të bollshme për të siguruar që ndryshimi është përfshirë në mënyrë të sigurt dhe me efikasitet. Kjo mund të demonstrohet duke ndërmarrë një proces të gatishmërisë operacionale, i cili mund të përfshijë simulimet, testimet, auditimet ose inspektimet e mostrave, duke i përfshirë pjesëmarrësit e duhur kryesor.

Pas përfundimit të ndryshimit, operatori i aerodromit duhet t'i konfirmojë AAC-së që i plotëson kriteret e përcaktuara të projektimit dhe është i përshtatshëm për këtë qëllim.

Kur ndryshimet ndikojnë në përmbajtjen e Manualit të aerodromit, këto ndryshime duhet të përfshihen, kurse AAC-së duhet ti dorëzohet një version i plotësuar.

Përveç kësaj, operatori i aerodromit të certifikuar duhet të paraqesë përsëri CB të ndryshuar, duke pasqyruar ndryshimet. AAC do të nënshkruajë CB për të konfirmuar aprovimin e tij dhe ia përcjellë këtë operatorit të aerodromit.

AAC do të ndryshojë certifikatën dhe kushtet e ndërlidhura të certifikatës për të përcaktuar pajtueshmërinë e vazhdueshme me Rregulloren Themelore dhe rregullat e zbatimit të saj.

## **KAPITULLI 6: Ndryshimet në sistemin e menaxhimit (vetëm aerodromet e certifikuara)**

Rregullorja Nr. 17/2017 për Aerodromet e certifikuara specifikon që ndryshimet që ndikojnë ndjeshëm në elementet e sistemit të menaxhimit të operatorit të aerodromit (siç janë listuar në ADR.OR.D.005 (b)) kërkojnë miratimin e AAC-së para se të mund të ndodhë ndryshimi.

AAC-ja më tej i ka përcaktuar këto si ndryshime që ndikojnë ndjeshëm në skemën organizative (ndryshime në linjat e përcaktuara qartë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies), në politikat ose kulturën e sigurisë së sistemit të menaxhimit të operatorit të aerodromit, përfshirë sistemin e menaxhimit të sigurisë.

Në praktikë, kjo nënkupton ndryshime në strukturën organizative (e kundërta kur postet individuale zëvendësohen në të njëjtën linjë (like-for-like basis)) ose ndryshime materiale në mënyrën e funksionimit të sistemit të menaxhimit dhe të SMS.

AAC-ja po kërkon prova nëse operatori i aerodromit ka burime të përshtatshme dhe kompetenca të sakta në strukturën e menaxhimit dhe nëse sistemi i menaxhimit mund të ofrojë siguri sipas rregullores. AAC pret që operatorët e aerodromeve të jenë në gjendje të demonstrojnë se si një strukturë organizative e ndryshuar ose një ndryshim i madh në sistemin e menaxhimit, do të jetë në gjendje të sigurojë menaxhimin e sigurtë të aerodromit, siç kërkohet me rregulloren. Për më tepër, AAC pret që operatori i aerodromit të ketë zhvilluar garantimin e sigurisë për të vërtetuar se ndryshimi do të menaxhohet gjatë çdo periudhe tranzicioni. AAC do të vlerësojë ndryshimin e propozuar kundrejt kërkesave të sistemit të menaxhimit dhe pret që procesi të përfundojë përpara se ndryshimi të hyjë në fuqi.

Nëse operatori i aerodromit nuk është i sigurt nëse ndryshimi në sistemin e menaxhimit kërkon aprovim paraprak, AAC-ja duhet të kontaktohet në instancën e parë.

Procesi i paraqitjes për ndryshime në sistemin e menaxhimit ndryshon pak nga ai i përdorur për infrastrukturën, e përshkruar më parë në këtë dokument. Çdo propozim duhet të përmbajë një përmbledhje të ndryshimit, duke përfshirë dokumentacionin mbështetës, (p.sh. Dokumentacionin e Garantimit të Sigurisë ose vlerësimin e ndryshimit), duke siguruar prova të qarta që ndryshimi përputhet me rregulloren përkatëse. Formularët e AAC-së, të disponueshme për ndryshime në infrastrukturë, janë të përshtatshme për plotësimin e ndryshimeve në sistemin e menaxhimit; megjithatë nuk ka ndonjë kërkesë për të plotësuar pjesën e matricës së përputhshmërisë të formularit të aplikimit.



Të gjithë anëtarët e ekipit të menaxhimit të ndryshimit duhet të kenë përgjegjësi dhe llogaridhënie të përcaktuara qartë në programin e ndryshimit. Këto janë thelbësore për të përmbushur kërkesat e certifikimit të aerodromit.

Operatorët e aerodromeve duhet të sigurojnë që të gjitha palët e interesuara të njoftohen me kohë për ndryshimin. Këto komunikime duhet të vazhdojnë përmes projektit dhe mund të përfshijnë Udhëzimet e Sigurisë dhe procedura e tjera lokale.

Me përfundimin e ndryshimit, operatori i aerodromit duhet t'i konfirmojë AAC-së që përmbush çdo kriter të dakorduar dhe është i përshtatshëm për qëllimin. Operatori i aerodromit duhet të ndryshon dhe plotëson Bazat e ndryshuara të Operacioneve (OB) dhe Manualin e Aerodromit dhe ta pasqyron ndryshimin. AAC do të nënshkruajë OB-në për të konfirmuar miratimin e saj dhe do t'ia përcjellë këtë operatorit të aerodromit.

## KAPITULLI 7: Ndryshimet që nuk kërkojnë aprovim paraprak (Vetëm aerodromet e certifikuara)

Me futjen e Rregullores Nr. 17/2017 për Aerodromet e certifikuara, ekzistojnë disa dallime delikate në mënyrën se si aprovohen nga AAC-ja ndryshimet në infrastrukturë dhe menaxhment. Këto dallime janë të rëndësishme vetëm për aerodromet e certifikuara.


Disa ndryshime nuk kërkojnë miratimin paraprak, para se të prezantohet ndryshimi. Sidoqoftë, që kjo të jetë në dispozicion, AAC-ja duhet të aprovojë procedurën e aerodromit për të menaxhuar ndryshime të tilla. Prandaj, është e domosdoshme që operatori i aerodromit t'i paraqesë AAC-së 'procedurën e menaxhimit të ndryshimit' për miratim, përpara fillimit të çfarëdo pune, dhe në mënyrë ideale në pikën e konvertimit të Certifikatës së tij.

Për shembull:

- Ndryshimet në mbajtësin e postit të menaxherit të përgjegjshëm;
- Ndryshimet në personat e emëruar;
- Zgjatjen e terminaleve që nuk ndikojnë në zonën e lëvizjes;
- Vendkalimet për udhëtarë;
- Zhvillimet e kufizuara në tokë që nuk kanë ndikim në zonën e lëvizjes;
- Kontejnerë të rinj lëvizës, ose pjesë shtesa për to;
- Përdorimi i vinçave;
- Reduktim i përkohshëm i paparashikuar në ShShZ;
- Mirëmbajtja e planifikuar paraprakisht dhe heqja e gomës.

Procedura për të menaxhuar këto ndryshime duhet të zhvillohet duke marrë parasysh politikat dhe proceset e aerodromit, por duhet të përfshijë si minimum:

- Llogaridhëniet për ndryshime;
- Një deklaratë të politikave për ato ndryshime që kërkojnë miratim paraprak;
- Përfshirja në Manualin e Aerodromit;
- Procesi për të ndërmarrë vlerësime të sigurisë, përfshirë analizën e rrezikut;
- Një listë e projekteve që kërkojnë/nuk kërkojnë aprovim paraprak; dhe
- Procesi, i pajtuar me AAC-në, se si do t'i jepen AAC-së njoftimet mbi ndryshimet që nuk kërkojnë miratim paraprak.



## KAPITULLI 8: Projektet e mirëmbajtjes

Projektet e mirëmbajtjes mund të ndryshojnë shumë në madhësi. Shumë punë të mirëmbajtjes përfshijnë punë të vogla afatshkurtra, si ngjyrosje, zëvendësime periodike të planifikuara (p.sh. pastrimi i dritave në përputhje me një orar të mirëmbajtjes preventive), rafinimet në sisteme/infrastrukturë dhe riparime të vogla në infrastrukturën e aerodromit, të cilat mund të përfundojnë në afate të shkurtra dhe me pengesa të kufizuara në punë. Për punët më të vogla të planifikuara ose rutinore të mirëmbajtjes nuk duhet të njoftohet AAC-ja, megjithëse AAC-ja do të priste të mbahej e informuar për këto aktivitete.

Sidoqoftë, mirëmbajtja mund të përfshijë gjithashtu edhe projekte të mëdha, afatgjata (javë/muaj), të cilat mund të përfshijnë shumë palë të interesuara kryesore, dhe të cilat mund të kenë ndikime të konsiderueshme në operacione dhe kështu të vejnë në pyetje sistemin e menaxhimit të sigurisë së aerodromit. Shembuj të mirëmbajtjes në shkallë të madhe do të përfshinin rehabilitimin e pjesshëm ose të plotë të pistës dhe zëvendësimin e sistemeve të ndriçimit tokësor të aerodromit.

AAC gjithashtu ka përfshirë punët e mëdha të mirëmbajtjes në procesin e aprovimit. Ky vendim bazohet në rrezikun ndaj të cilit është i ekspozuar operatori i aerodromit derisa është duke ndërmarrë projekte të mëdha të mirëmbajtjes që normalisht përfshijnë shumë palë të interesuara dhe procedura komplekse operative gjatë projektit.

AAC do të vlerësojë propozimin dhe, pasi të ketë përfunduar vlerësimin, dhe sigurohet se aerodromi mund t'i kryejë punët e mëdha të mirëmbajtjes në mënyrë të sigurt, AAC do të konfirmojë miratimin e tij me shkrim.

## KAPITULLI 9: Vlerësimi i rrezikut të sigurisë

Të gjitha zhvillimet pritet të plotësojnë kriteret e detajuara në Rregulloren Nr. 17/2017 për Aerodromet e certifikuar, Rregulloren për Aerodromet e miratuara, Aneksin 14 të ICAO-s ose rregulloret e tjera të zbatueshme. Për më tepër, gjatë procesit të planifikimit, variacionet ekzistuese në aerodrom (nëse ekzistojnë) duhet të ekzaminohen për të përcaktuar nëse ato mund të hiqen ose përmirësohen si pjesë e zhvillimit.

Prandaj, një vlerësim i rrezikut, që tregon qartë se rreziku është në një nivel të pranueshëm si për menaxhmentin e aerodromit ashtu edhe për AAC-në, është i nevojshëm. Përgatitja dhe financimi i vlerësimit është përgjegjësi e aerodromit.

Lloji i vlerësimit të rrezikut të sigurisë së ndërmarrë do të ndryshojë në varësi të rrezikimit të sigurisë nga zhvillimi. Nëse pasojat e mundshme do të ishin një aksident i rëndë për një avion (dëme të konsiderueshme ose më keq), mund të kërkohej një analizë e plotë kuantitative nga specialistë të sigurisë. Sidoqoftë, në shumë rrethana kur ashpërsia e rreziqeve të mundshme nuk është e madhe ose lehtë mund të zbutet, vlerësimi i rrezikut të sigurisë mund të bëhet nga një grup i vogël ekspertësh të aerodromit, duke përdorur përvojën e tyre dhe njohuritë e specializuara. **Duhet të theksohet se dorëzimi i një vlerësimi rreziku ose të sigurisë nuk garanton automatikisht pranimin e një projekti.**

Cilido krahasuesi i rrezikut që të jetë zgjedhur, menaxhmenti i aerodromit duhet të jetë i vetëdijshëm se do nuk të ishte e mençur të fillohet një zhvillim para se AAC të sigurojë që nuk ka kundërshtime për të.

Informacioni i mëtejshëm mbi vlerësimin e rrezikut të sigurisë është paraqitur në Shtojcën A.

## SHTOJCA A: Metodologjia e vlerësimit të rrezikut të sigurisë

### 1. Hyrje

Një organizatë duhet të vlerësojë të gjitha aspektet e funksionimit të saj dhe ndryshimet në të, për rëndësinë e sigurisë. Vlerësimet e sigurisë duhet të kryhen dhe të dokumentohen për të siguruar që i kushtohet vëmendje e duhur sigurisë së të gjitha pjesëve të sistemit.

Një vlerësim i sigurisë për një ndryshim duhet të përfshijë:

- a) identifikimin e shtrirjes të ndryshimit;
- b) identifikimin e rreziqeve;
- c) përcaktimin e kriterëve të sigurisë që zbatohen për ndryshimin;
- d) analizën e rrezikut në lidhje me efektet e dëmshme ose përmirësimet e sigurisë në lidhje me ndryshimin;
- e) vlerësimin e rrezikut dhe, nëse kërkohet, zbutjen e rrezikut të ndryshimit për të përmbushur kriteret e zbatueshme të sigurisë;
- f) verifikimin se ndryshimi përputhet me shtrirjen që ishte objekt i vlerësimit të sigurisë dhe i plotëson kriteret e sigurisë, përpara se të vihet në veprim; dhe
- g) specifikimi i kërkesave të monitorimit të nevojshme për të siguruar që aerodromi dhe funksionimi i tij do të vazhdojnë të plotësojnë kriteret e sigurisë pasi të ketë ndodhur ndryshimi.

### 2. Shtrirja e vlerësimit të sigurisë

Shtrirja e vlerësimit të sigurisë duhet të përfshijë elementet e mëposhtme dhe bashkëveprimin e tyre:

- a) aerodromi, funksionimi i tij, menaxhmenti dhe elementet njerëzore që ndryshohen;
- b) ndërlidhjet dhe ndërveprimet midis elementeve që ndryshohen dhe pjesës tjetër të sistemit;
- c) ndërlidhjet dhe ndërveprimet midis elementeve që ndryshohen dhe mjedisit në të cilin synohet të funksionojë; dhe
- d) ciklin e plotë të ndryshimit nga përkufizimi deri tek operimi.

### 3. Kriteret e sigurisë

Kriteret e përdorura të sigurisë duhet të përcaktohen në përputhje me procedurat për menaxhimin e ndryshimit, të përfshira në manualin e aerodromit.

Kriteret e përdorura të sigurisë, në varësi të disponueshmërisë së të dhënave, duhet të specifikohen duke iu referuar niveleve të qarta kuantitative të pranueshme të

rrezikut të sigurisë, standardeve të njohura, dhe/ose kodeve të praktikës, performancës së sigurisë së sistemit ekzistues, ose një sistemi të ngjashëm.

Më shumë informata mbi metodologjinë e vlerësimit të rrezikut të sigurisë mund të gjenden në Kapitullin 4 të Publikimit Teknik “TP-26 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë (SMS) për Ofruesit e Shërbimeve”, publikuar nga AAC. Ky publikim ka për qëllim të sigurojë materiale udhëzuese për ofruesit e shërbimeve për zbatimin e Sistemeve të Menaxhimit të Sigurisë (SMS) dhe për të kuptuarit e mjaftueshëm të koncepteve SMS dhe zhvillimin e politikave dhe proceseve të menaxhimit për të zbatuar dhe mbajtur një SMS efektiv.

## SHTOJCA B: Procesi i ndryshimit – Grafiku i rrjedhës

